

Datë 12.06.2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim printimi”.

Dhe fotokopjimi për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave

REF-09110-06-02-2024

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **79800000-2.**

VLERA E FONDIT LIMIT: **3,772,600 (tre milion e shtatë qind e shtatë dhjetë e dy mijë e gjashtë qind)** lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: Sipas KPK.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomike duhet të paraqesin xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra vlerën e 40% te fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare.*

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori

ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

***Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021, me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitetin financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

2.3 Kapaciteti teknike dhe profesionale:

- 1.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 19% e vlerës**. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror dhe/ose faturat tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimeve të realizuara.
- Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshminë përkatëse, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe **të deklaruara në organet tatimore**, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimeve të realizuara.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën në vlerën jo më pak se 19% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2. Operoret ekonomike pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të kenë të punësuar të paktën:

- a. 2 dy inxhinierë të fushës së teknologjisë së informacionit IT, informatikës, inovacionit, elektronikës, mekanik (cdo degë që lidhet me objektin e prokurimit)-për këta punonjës të paraqitet diploma e kërkuar dhe kontrata e punës e vlefshme me operatorin ekonomik ofertues ose e-sig-et e muajit të fundit të OE ekonomik ku të cilësohet profesioni si inxhinier.

Argumentim: Kjo kërkesë vjen si kusht kryesor për kapacitetin profesional të OE ofertues. Profili i kërkuar lidhet ngushtë me objektin e prokurimit dhe le të hapur cdo fushë të teknologjisë së informacionit, elektronikës, inovacionit dhe cdo fushë tjetër të diplomimit në shqiperi dhe nderkombëtarisht që lidhet me objektin e prokurimit që është shërbim printimi dhe fotokopjimi. Kërkohet një numër prej dy punonjësish, si numër minimal për zbatimin e grafikut të parashikuar të punës në DPA dhe njesite e saj, ku janë një numër prej 10 qendrash/ njesi ku do të zbatohet kjo marrëveshje kuader. Të paktën një inxhinier për 5 qendra është një kërkesë minimale profesionale.

- b. 2 dy punonjës teknikë për objektin e prokurimit-ne lidhje me këta punonjës të paraqitet kontrata e punës ku të cilësohet pozicioni i punës si staf teknik ose e-sig-et e muajit të fundit të OE ku të cilësohet pozicioni si staf teknik.

Argumentim: Kërkesa për dy punonjës teknik vjen si kërkesë e zbatimit në terren e marrëveshjes kuader, të cilat do të jenë në gadishmeri për cdo pyetje, paqartësi, defekt apo cdo nevojë që lind gjatë zbatimit të marrëveshjes kuadër. Gjithashtu do të shërbejnë për mirëmbajtjen e pajisjeve ekzistuese, të cilat janë përmendur në Specifikimet Teknike dhe që janë pjesë e zbatimit të marrëveshjes kuader.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/a,b,c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

3. Operatori ekonomik duhet të disponoje pajisjet, si më poshtë:

Emertimi	Njësia	Sasia	Statusi Në pronësi/me qira
Fotokopje Multifunksionale (B&W MFP Basic)	Cope	10	
Printer A4 B/w MFP (printer/skaner/fotokopje	Cope	5	
Printer A4 Color	Cope	1	

Pajisjet duhet ti kete ne pronesi, me qira apo ne perdorim. Per kete te paraqitet dokumenti i pronesisë, fature tatimore blerje apo cdo dokument tjetër që verteton pronesisë. Nëse pajisjet janë me qira apo përdorim duhet të paraqitet kontrata e qirase apo huapërdorjes me afat jo me pak se ai I marreveshjes kuader.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e shërbimit për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Pajisje të kërkuara nga autoriteti kontraktor përfitues fundor i këtij shërbimi.

4. Operatori ekonomik duhet të duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës të deklarojë se riparimi i pajisjes së difektuar do të riparohet brenda 24 orë nga njoftimi, në çdo vend të instalimit të pajisjes.

Argumentim: Kjo kerkese vjen si kerkese e lidhur ngushte me objektin e prokurimit si nje shërbim out-source që do të zbatohet pranë AK Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave dhe njesive te saj.

Shënim: Rastet kur konstatohen deklaratat të rreme, të paraqitura nga operatorët ekonomik në përmbushje të kriterëve kualifikuese, do të konsiderohen si kusht për skualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për perjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përlogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor *Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave*, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh. a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: Data: 25/06.2024; Ora: 13:00;

Vendi: www.app.gov.al, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, Tiranë.

NJESIA E PROKURIMIT